



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:286771

Datë: 14.07.2020

Numri i dokumentit: 01023900

P.nr.1651/2019

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal,** gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit **I.M** nga fsh.... Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mosedhenia e ndihmes personit te lendar ne fatekeqesine e trafikut publik nga neni 374 par.1 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.2269-9/2019 të datës 06.12.2019, pas mbajtjes së seancës fillestare gjyqesore publike, në prezencën e Prokurorit Themelore te shtetit në Prizren Shahadin Destani, të akuzuarit, me datë **06.07.2020**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

## AKTGJYKIM

I akuzuari **I.M**, nga i ati M., e ëma Xh., e vajzërisë K, i lindur më datë .... në fsh..... Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, i martuar baba i ... femijeve, ka të kryer shkollen fillore, pensionist, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves,

## ËSHTË FAJTOR

Se me date 16.09.2019, rreth ores 09,15 min, ne Prizren, ne rr....., saktesishte afer picerise”...”, i pandehuri derisa drejtonte automjetin e markes”...” me regj....., ngjyre te bardhe, pasi qe shkakton aksident komunikacioni, me lendime te lehta trupore te demtuarit-kembesorit te mitur U.M, nuk ndalet dhe nuk i ofron ndihme te demtuarit me ate mjete te transportit, me te cilin ka shkatuar aksident ko,umikacioni me lendime trupore, por i pandehuri largohet nga vendi i ngjarjes, dhe me pas identifikohet nga ana e policise me ane te video inqizimeve,

-kësodore kryen veprën penale te mosedhenje te ndihmes personit te lendar ne fatekeqesin e trafikut publik nga neni 374 par.1 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, të KP-se, si dhe nenit 365 të KP-se, të akuzuarit i shqipton:

## D E N I M M E G J O B E

Ne lartësi prej **200,00 /dyqind/ Euro** të cilën shumë të denimit të akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotefuqishmerisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari denimin nuk e pagun edhe pas ekzekutimit me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me denim burg duke llogaritur për çdo 20 Euro një ditë burg, respektivisht 10 ditë burgim.

I akuzuari obligohet që do të paguaj të gjitha shpenzimet të procedurës penale, në emër të shpenzimeve të paushalit gjyqësor shumen prej **30,00 euro**, në emër të kompenzimit për viktimat e krimit shumen prej **30,00 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotefuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Të demtuarit **U.M** me perfaqësuesin e tij ligjor babain **S.M** nga Prizreni, rr..... nr....., për realizimin e kërkesës pasuroro juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civilo juridik.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën me PP. nr.2269-9/2019 të dt.06.12.2019, kundër të akuzuarit **I.M** nga fsh..... Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mesedhenia e ndihmes personit të lënduar në fatekqesinë e trafikut publik nga neni 374 par.1 të KP-es.

Gjykata në shqyrtim kryesor ka vërtetuar gjendjen e këtyre faktike nga pranimi i fajësive nga ana e të akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, për shkak të se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në teresi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësive për veprën penale e cila i vihet në bërë, e që pranimi i fajësive është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime, duke u mbështetur në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykat ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësive nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-se, dhe faktet që përmban aktakuzën, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të mosdhenjes së ndihmes personit të lënduar në fatekqesinë trafikut publik nga neni 374 par.1 të KP-se, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe si të merituar, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale-juridike.

Me rastin e caktimit të denimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-se të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht rënduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësive nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tij, në kuptim të dispozitave të nenit 69, 70, e 71 gjykata morri për bazë edhe faktin që i akuzuari ka bashkëpunuar me gjykatën, bashkëpunimi i tij ka qenë vullnetar në hetimin dhe ndjekjen penale, ka pranuar fajesin dhe ka shprehur keqardhje për veprën e kryer penale si dhe publikisht i ka kërkuar falje të demtuarit, dhe pasqyruar edhe ka pasur sjellje korrekte para gjykatës, premtonte se në të ardhmen do të jete me i kujdesshem në trafik, shpreh gadishmeri të kompenzojë dëmin e shkaktuar me veprën e kryer penale, mbajtes i familjes 8 antareshe, pensionist, andaj gjykata i shqiptoi denimin me gjobe sepse konsideron se me këto masa sanksionuese do të arrihet qëllimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i përgjigjet

shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete i kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 453 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr. 1651/2019 të datës 06.07.2020**

**Sekretare Juridike**  
**Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari**  
**Fatmir Krasniqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kunder ketij aktgjykimi pala e pakenaqur ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtes, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.